



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:254816

Datë: 03.07.2023

Numri i dokumentit: 04565211

C.nr.1494/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Nexhat Qallapeku, në çështjen juridike të paditësve F.M, nga fshati P....., Komuna e Prishtinës, N.K dhe B.TH nga Obiliqi, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Avokatura MBN Sh.P.K me avokatët Mexhid Syla, Blerim Syla dhe Nexhat Syla, me seli në Prishtinë, Rruga “UÇK”, kompleksi Qafa, kati II-të, numër 25, kundër të paditurave Kompania e Sigurimeve “S....” me seli në Prishtinë, Rruga ”Edmond Hoxha”, përfaqësuar nga Feride Ceka Marevci, avokate në Prishtinë, dhe Kompania e Sigurimeve ”I....” me seli në Prishtinë, sheshi “Nënë Terezë”, përfaqësuar nga Ardit Baxhuku, zyrtar ligjor pranë të paditurës, me objekt kontesti kompensim dëmi material dhe jo material, vlera e kontestit 15,061.90€, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik të datës 14.06.2023, të mbajtur me prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse, me datë 03.07.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT si e bazuar kërkesëpadia e paditësve F.M, nga fshati P....., Komuna e Prishtinës, N.K dhe B.TH, nga Obiliqi.
- II. Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “S....”, me seli në Prishtinë, që paditësve F.M, N.K dhe B.TH, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 11.05.2016, nga baza e auto përgjegjësisë, për 80 % të përgjegjësisë, t’ia paguaj shumat si vijon:

Paditësit F.M

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej ..... 1,200.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej ..... 840.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej..... 117.60€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej ..... 117.60€
- Për shpenzime materiale për shërim, shumën prej ..... 23.76€

**Paditësit N.K**

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej..... 1,600.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej ..... 1,142.40€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej..... 117.60€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej ..... 117.60€

**Paditësit B.TH**

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej..... 1,200.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej ..... 840.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej..... 117.60€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej ..... 117.60€
- Për shpenzime materiale për shërim, shumën prej ..... 25.76€

III. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “I...”, me seli në Prishtinë, që paditësve N.K dhe B.TH, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 11.05.2016, nga baza e auto përgjegjësisë, për 20% të përgjegjësisë, t’ua paguaj shumat si vijon:

**Paditësit N.K**

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej..... 400.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej ..... 285.60€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej..... 29.40€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej ..... 29.40€

Paditësit B.TH

Në emër të dëmit jo material:

- Për dhimbje trupore - fizike, shumën prej ..... 300.00€
- Për frikën e pësuar, shumën prej ..... 210.00€

Në emër të dëmit material:

- Për ushqim të përforcuar, shumën prej ..... 29.40€
- Për përkujdesje të personit të huaj, shumën prej ..... 29.40€
- Për shpenzime materiale për shërim, shumën prej ..... 6.44€

IV. DETYROHEN të paditurat që paditësve prestimet si në pikën –II- dhe –III- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ua paguaj kamatën në lartësi prej 8% në vit, dhe atë për dëmin material e paditura Kompania e Sigurimeve “S....” nga data e parashtrimit të kërkesës për kompensim, 20.05.2016, ndërsa e paditura Kompania e Sigurimeve “S....” nga data e njoftimit të të paditurës për zgjerimin e padisë, 25.08.2022, kurse për dëmin jo material, të dy të paditurat, nga data marrjes së këtij aktgjykimi, 03.07.2023, e deri në pagesën e tërësishme, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

V. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve F.M, N.K dhe B.TH, mbi shumat e aprovuara si në pikën –II- dhe –III- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe atë: Për paditësin F.M, për dhimbje trupore - fizike shumën prej 800.00€, për frikën e pësuar shumën prej 1,160.00€, për ushqim të përforcuar shumën prej 182.40€, për përkujdesjen e personit të huaj shumën prej 182.40€, për shpenzime të shërimit shumën prej 5.94€, dhe për rehabilitim fiziko – terapeutik dhe psikik shumën prej 400.00€. Për paditësin Naim Konjusha: për frikën e pësuar shumën prej 572.00€, për ushqim të përforcuar shumën prej 153.00€, për përkujdesjen e personit të huaj shumën prej 153.00€ dhe për rehabilitim fiziko – terapeutik dhe psikik shumën prej 400.00€. Për paditësin B.TH për dhimbje trupore - fizike shumën prej 500.00€, për frikën e pësuar shumën prej 950.00€, dhe për ushqim të përforcuar shumën prej 153.00€, për përkujdesjen e personit të huaj shumën prej 153.00€ dhe për rehabilitim fiziko – terapeutik dhe psikik shumën prej 400.00€.

VI. DETYROHEN të paditurat që paditësve si në pikën –II- dhe -III- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ua kompensojnë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,636.68€ (njëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e tetë cent),

dhe atë e paditura e parë, Kompania e Sigurimeve “S....”, për 80% të përgjegjësisë, për tre paditës, shumën prej 1,355.52€, ndërsa e paditura e dytë, Kompania e Sigurimeve “I....”, për 20% të përgjegjësisë, për dy paditës, shumën prej 281.168€, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim

## A r s y e t i m

Paditësit, F.M, N.K dhe B.TH, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, me datë 06.07.2023, në këtë gjykatë, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S....”, ndërsa me parashtrësën e datës 23.08.2019, kanë zgjeruar padinë edhe ndaj Kompanisë së Sigurimeve “I....”, me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi material dhe jo material.

Paditësit, përmes përfaqësuesit të tyre të autorizuar, në padi, përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare kanë theksuar se me datë 11.05.2016, rreth orës 22:00 në rrugë “F.C” në Obiliq, është shkaktuar aksident komunikacioni. Deri te aksidenti kishte ardhur me fajin e ngasësit të automjetit nën A (0.....), i cili kyçet në rrugë në shenjën stop dhe në mënyrë të pasigurt, ku e godet automjetin B (0.....), i cili po lëvizte në rrugë, si pasojë e kësaj goditje lëndime trupore pësojnë tani paditësit. Kanë shtuar se të paditurat mbajnë përgjegjësi për kompensimin e dëmit paditësve, mbi bazën e auto përgjegjësisë, pasi që shkaktar primar i aksidentit ka qenë i siguruari tek e paditura Kompania e Sigurimeve “S....” Sh.A., ndërsa shkaktar sekondar ka qenë i siguruari tek e paditura e dytë Kompania e Sigurimeve “I....” Sh.A. Mbi bazën e kësaj i kanë propozuar gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, ashtu që të detyrohen të paditurat, Kompania e Sigurimeve “S....” dhe Kompania e Sigurimeve “I....”, sipas përgjegjësisë, që paditësve N.K dhe B.TH, t’ua kompensojë dëmin, dhe atë: Paditësit N.K, në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 2,000.00€, për frikën e pësuar shumën prej 2,000.00€, për ushqim të përforcuar shumën prej 300.00€, për përkujdesje të personit të huaj shumën prej 300.00€, për rehabilitim shumën prej 400.00€. Për paditësit B.TH, në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 2,000.00€, për frikën e pësuar shumën prej 2,000.00€, për ushqim të përforcuar shumën prej 300.00€, për përkujdesje të personit të huaj shumën prej 300.00€, për rehabilitim shumën prej 400.00€, për shpenzimet e mjekimit shumën prej 32.20€. Si dhe obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve “S....” me seli në Prishtinë, që paditësit F.M, sipas përgjegjësisë, t’ia kompensojë dëmin material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e datës 11.05.2016, dhe atë: në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 2,000.00€, për frikën e pësuar shumën prej 2,000.00€, për

ushqim të përforcuar shumë prej 300.00€, për përkujdesje të personit të huaj shumë prej 300.00€, për rehabilitim shumë prej 400.00€, për shpenzimet e mjekimit shumen prej 29.70€. Të gjitha këto me kamatë 12%, duke filluar nga dita e paraqitjes së kërkesës për kompensim 20.05.2016 e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga data e pranimit të aktgjykimit nën kërcenim të përmbarrimit të detyruar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë të përgjithshme prej 4,128.00€, dhe atë: 520.00€ për padi, 2,028.00€ për përfaqësimin e paditësve në tri seanca gjyqësore ( 3 x 676.00€), 520.00€ për parashtrësën mbi precizimin e kërkesëpadiës, 520.00€ për parashtrësën mbi zgjerimin e padisë, 500.00€ për marrjen e provës me ekspertiza mjekësore dhe 40.00€ për taksë gjyqësore për padi.

E paditura e parë Kompania e Sigurimeve "S...." përmes përfaqësueses me autorizim, në përgjigje në padi dhe në seancat e shqyrtimit gjyqësor dhe fjalën përfundimtare, e ka kontestuar pjesërisht kërkesëpadinë për nga baza dhe lartësia, duke theksuar se shkaktar të aksidentit të datës 11.05.2016, kanë qenë të dy pjesëmarrësit në aksident dhe atë shkaktar primar i siguruari tek Kompania e Sigurimeve "S....", ndërsa shkaktar sekondar i siguruari i të paditurës "I....". Ka shtuar se pranon përgjegjësinë në shkaktimin e dëmit në proporcion prej 80%, duke ofruar për kompensim shumë prej 1,000.00€ për secilin paditës. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve, ndaj të paditurës së parë, mbi shumë prej 1,000.00€ për secilin paditës, ta refuzoj. Po ashtu ka kundërshtuar dhe lartësinë e kamatës prej 12% me pretendim se e njëjta është në kundërshtim me Ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura e dytë Kompania e Sigurimeve "I....." përmes përfaqësueses me autorizim, në përgjigje në padi dhe në seancat e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e konteston kërkesëpadinë nga baza juridike me pretendimin se kërkesa e paditësve ndaj të paditurës së dytë është parashkruar. Deri te parashkrimi i kërkesës ka ardhur për faktin se aksidenti i komunikacionit, ku edhe është shkaktuar dëmi, ka ndodhur me datë 11.05.2016, ndërsa padia ndaj të paditurës së dytë është zgjeruar me datë 23.08.2019, pasi që kanë kaluar tri vite nga koha e shkaktimit të dëmit. Ka shtuar se e kundërshton edhe kamatën e kërkuar nga paditësit, prej 12% në vit, nga se e paditura e dytë, nuk ka pranuar kërkesë për kompensim të dëmit, nuk ka pasur ndonjë vonesë në trajtimin e kërkesës, dhe se për herë të parë për kontestit është informuar me datë 25.08.2022. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ndaj të paditurës së dytë ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruara provat: Raportin Policor me numër 2016-AR-1140 të datës 11.05.2016, Ekspertizën e Komunikacionit Rrugor të muajit qershor 2016, punuar nga eksperti Menduh Halili, Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë me numër P.nr. 4527/18 të datës 06.05.2019, Njoftimin me numër 670/05/16 të datës 29.06.2016, Ekspertizën mjekësore të datës 20.04.2023, punuar nga ekspertet Dr.Sami Delijaj -Ortoped dhe Bujar Obertinca- Psikiatër, si dhe: Për paditësin F.M: Raportin e Qendrës Klinike Universitare - Qendra Emergjente me numër 18850, të datës 11.05.2016, Dëftesën me numër 248412, të datës 11.05.2016, Dëftesën me numër 277440, të datës 12.05.2016, Kuponin fiskal me numër 0015, të datës 12.05.2016, lëshuar nga NSH "S....". Për paditësin N.K: Raportin e Qendrës Klinike Universitare - Qendra Emergjente me numër 18855 të datës 11.05.2016, Kuponin Fiskal me numër 0016, të datës 12.05.2016, lëshuar nga NSH "S....". Për paditësin B.TH: Raportin e Qendrës Klinike Universitare - Qendra Emergjente me numër 18848, të datës 11.05.2016, Dëftesën numër 248413, të datës 11.05.2016 dhe kuponin fiskal numër 0014, të datës 12.05.2016, lëshuar nga NSH "S....".

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118 (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha se bashku, dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pjesërisht e bazuar duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datë 11.05.2016, rreth orës 22:00, në Obiliq, rruga "F.C", është shkaktuar aksident i komunikacionit rrugor, në të cilin ishin përfshirë automjetet me numër të targave 0....., i siguruar tek e paditura Kompania e Sigurimeve "S...." Sh.A., dhe automjetit me numër të targave 02-755-DC, i siguruar tek e paditura Kompania e Sigurimeve "I...." Sh.A.

Po ashtu mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se në aksidentin e datës 11.05.2016, lëndime kishin pësuar të gjithë paditësit, të cilët në kohën e aksidentit ishin në automjetin me numër të targave 0....dhe atë paditësi F.M drejtues i automjetit, kurse B.TH dhe N.Kudhëtar në këtë automjet. Këto fakte jo kontestuese provohen edhe me raportin e aksidentit numër 2016-AR-1140, të datës 11.05.2016, të përpiluar nga Policia e Kosovës.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse mbetet parashkrimi i kërkesës në raport me të paditurën e dytë, Kompania e Sigurimeve “I...” dhe lartësia e kërkesëpadisë së paditësve.

Me Raportin policor me numër 2016-AR-1140 i datës 11.05.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 11.05.2016, në Obiliq, ka ndodhur aksident i komunikacionit mes automjetit të markës Nissan, me numër të targave 0....., të cilin e ngiste Gani Sallova, dhe automjetit të markës VW, me numër të targave 0....., të cilin e ngiste F.M. Si pasojë e këtij aksidenti lëndime kanë pësuar paditësit F.M,B.TH dhe Naim Konjusha, si dhe ngasësi i automjetit 0....., Gani Sallova.

Me ekspertizën e Komunikacionit Rrugor, të datës 12.06.2016, të punuar nga eksperti Menduh Halili, gjykata ka vërtetuar faktin se deri te aksidenti i komunikacionit rrugor ka ardhur për shkak të mos respektimit të kushteve të qarkullimit sipas gjendjes dhe kushteve faktike në rrugë. Përgjegjësi primare në shkaktimin e aksidentit mban i siguruari tek Kompania e Sigurimeve “S...”, i cili nuk ka respektuar shenjë të komunikacionit “ndalje e detyruar – STOP”, dhe ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm të komunikacionit, ndërsa përgjegjësi sekondare në shkaktimin e aksidentit ka i siguruari tek Kompania e Sigurimeve “I...”, i cili nuk ka respektuar shpejtësinë e lejuar dhe ka shkaktuar rrezik të përgjithshëm të komunikacionit.

Gjykata ekspertizën nga lëmi i komunikacionit rrugor e ka pranuar në tërësi si të besueshme, meqë ishte profesionale dhe e argumentuar mirë, dhe nga palët ndërgjyqëse kishte dakordim që e njëjta të administrohet si provë në këtë procedurë, ndaj të cilës nuk kishin vërejtje.

Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me përgjegjësi të ndarë sipas kontributit të pjesëmarrësve në aksident dhe ka vendosur që përgjegjësia të jetë 80% për të paditurën e parë, Kompaninë e Sigurimeve “S...” Sh.A. dhe 20% për të paditurën e dytë, Kompania e Sigurimeve “I...” Sh.A., me të cilën përqindje të ndarjes së përgjegjësisë ishin pajtuar edhe palët ndërgjyqëse.

Me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, numër 4527/18 i datës 06.05.2019, në çështjen penale kundër të pandehurve, G.S dhe F.M, këtu paditës, është hedhur aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.2636/2016 e datës 17.10.2018 dhe është pushuar procedura penale lidhur me veprën penale rrezikim i trafikut publik me arsyetimin se vepra penale për të cilën akuzohen nuk përbën vepër penale.

Nga raporte mjekësore të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës - Qendra Emergjente me numra 18848, 18850 dhe 18855, që të gjitha të datës 11.05.2016, Gjykata ka vërtetuar faktin se në ditën e aksidentit, të gjithë paditësit janë paraqitur pranë këtij institucioni shëndetësor, i cili ka evidentuar lëndimet e pësuar të paditësve dhe të njëjtit kanë pranuar edhe tretman mjekësor.

Nga njoftimi me numër 670/05/16 i datës 29.06.2016, Gjykata ka konstatuar faktin se paditësit kanë parashtruar kërkesë tek e paditura e parë, Kompania e Sigurimeve “S....”, për kompensimin e dëmit të pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 11.05.2016, e cila brenda afateve ligjore nga neni 26 të Ligjit Nr.04/L-018, ka trajtuar dhe vendosur në kërkesën e këtu paditësve, duke i njohur kompensim në shumë prej 245.00€.

Për të përcaktuar natyrën dhe shkallën e lëndimeve në këtë aksident trafiku, gjykata me propozimin e palës paditëse ka nxjerrë provën përmes ekspertizës, me ekspertë nga lëmi i Ortopedisë dhe Psikiatrisë.

Eksperti ortoped, Dr. Sami Delijaj, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi *F.M*, si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, ndrydhje të regjionit të kokës, ndrydhje dhe përdredhje e regjionit të qafës, ndrydhje e regjionit të gjoksit, që cilësohen si lëndime të lehta trupore. Paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra, ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë nuk ka pasur. Dhimbje me intensitet të rëndë ka pasur 48 orë, me theks të veçantë në regjionin e kokës, qafës dhe gjoksit. Paditësi ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 3 javësh, gjatë të cilës periudhë është ordinuar terapia kundër dhimbjes dhe është vendosur qaforja. Dhimbje me intensitet të ulët paditësi ka qenë prezentë në periudhë kohore prej 12 muajsh, herë pas here, kryesisht gjatë ndryshimeve klimatike dhe pozitive të detyruara. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka konstatuar se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 3 jave, që ka konsistuar në ndihmën e nevojshme për aktivitet e përditshme jetësore, si ushqimi, veshmbathja, higjiena dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 3 javë, ushqim i pasur me proteina, prodhime të qumështit, minerale, vitamina, etj., i nevojshëm për rritjen e imunitetit dhe përforcim të organizmit në tërësi pas lëndimit. Eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik në periudhë kohore prej 10 ditë. Eksperti ka konstatuar se paditësi nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe nuk ka shëmtim trupor.

Eksperti i psikiatrisë, Dr. Bujar Obertinca, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi *F.M*, si pasojë e aksidentit, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare ka përjetuar disa sekonda, e përcjell me ndjenjën e përfundimit të jetës. Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 1 orë, në formë të konfuzionit, brengës për paraqitjen e pasojave. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 3



muaj, e manifestuar me vështirësi rreth adaptimit në kushtet e reja për shkak të lëndimeve të kokës dhe lëvizjeve të kufizuara (bartjes së qafores), duke i shkaktuar pengesa në realizimin e aktiviteteve të përditshme, e që në aspektin psikik i kanë shkaktuar ankth, ankth, pagjumësi, dridhje të trupit, irritabilitet, inkontiençë emocionale, ulje të pragut të reagimit në situata frustrative. Frikë sekondare të intensitetit të ulët ka përjetuar në kohëzgjatje prej 12 muajve, herë pas here.

Eksperti ortoped, Dr. Sami Delijaj, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi *N.K.*, si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, ndrydhje të regjionit të kokës, të shoqëruara me plagë gërvishtëse të regjionit të ballit, ndrydhje dhe përdredhje e regjionit të qafës, ndrydhje e regjionit të gjoksit dhe shpinës, që cilësohen si lëndime të lehta trupore. Paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra, ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë nuk ka pasur. Dhimbje me intensitet të rëndë ka pasur 72 orë, me theks të veçantë në regjionin e kokës, qafës, gjoksit dhe shpinës. Paditësi ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 4 javësh, gjatë të cilës periudhë është ordinuar terapia kundër dhimbjes dhe është vendosur qaforja. Dhimbje me intensitet të ulët paditësi ka qenë prezentë në periudhë kohore prej 2 vitesh, herë pas here, kryesisht gjatë ndryshimeve klimatike dhe pozitive të detyruara. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka konstatuar se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 3 jave, që ka konsistuar në ndihmën e nevojshme për aktivitet e përditshme jetësore, si ushqimi, veshmbathja, higjiena dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 3 javë, ushqim i pasur me proteina, prodhime të qumështit, minerale, vitamina, etj., i nevojshëm për rritjen e imunitetit dhe përforcim të organizmit në tërësi pas lëndimit. Eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik në periudhë kohore prej 10 ditë. Eksperti ka konstatuar se paditësi nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe nuk ka shëmtim trupor.

Eksperti i psikiatrisë, Dr. Bujar Obertinca, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi *N K.*, si pasojë e aksidentit, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare ka përjetuar disa sekonda, e përcjell me ndjenjën e përfundimit të jetës. Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 1 orë, në formë të konfuzionit, brengës për paraqitjen e pasojave. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 4 muaj, e manifestuar me vështirësi rreth adaptimit në kushtet e reja për shkak të lëndimeve të kokës dhe lëvizjeve të kufizuara (bartjes së qafores), duke i shkaktuar pengesa në realizimin e

aktiviteteve të përditshme, e që në aspektin psikik i kanë shkaktuar ankth, ankth, pagjumësi, dridhje të trupit, irritabilitet, inkontiençë emocionale, ulje të pragut të reagimit në situata frustrative. Frikë sekondare të intensitetit të ulët ka përjetuar në kohëzgjatje prej 2 vite, herë pas here.

Eksperti ortoped, Dr. Sami Delijaj, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor, i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi *B.TH*, si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, ndrydhje të regjionit të kokës, ndrydhje dhe përdredhje e regjionit të qafës, ndrydhje e regjionit të gjoksit, që cilësohen si lëndime të lehta trupore. Paditësi, si pasojë e lëndimeve të marra, ka pësuar dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme. Dhimbje me intensitet posaçërisht të rëndë nuk ka pasur. Dhimbje me intensitet të rëndë ka pasur 48 orë, me theks të veçantë në regjionin e kokës, qafës, gjoksit dhe shpinës. Paditësi ka pasur dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 3 javësh, gjatë të cilës periudhë është ordinuar terapia kundër dhimbjes dhe është vendosur qaforja. Dhimbje me intensitet të ulët paditësi ka qenë prezentë në periudhë kohore prej 12 muaj, herë pas here, kryesisht gjatë ndryshimeve klimatike dhe pozitive të detyruara. Lidhur me nevojën për ndihmën e personit të tretë, eksperti ortoped ka konstatuar se ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 3 jave, që ka konsistuar në ndihmën e nevojshme për aktivitetet e përditshme jetësore, si ushqimi, veshmbathja, higjiena dhe ndihma gjatë trajtimit mjekësor. Ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 3 javë, ushqim i pasur me proteina, prodhime të qumështit, minerale, vitamina, etj., i nevojshëm për rritjen e imunitetit dhe përforcim të organizmit në tërësi pas lëndimit. Eksperti ka konstatuar se për paditësin ka qenë i nevojshëm edhe rehabilitimi fizioterapeutik në periudhë kohore prej 10 ditë. Eksperti ka konstatuar se paditësi nuk ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe nuk ka shëmtim trupor.

Eksperti i psikiatrisë, Dr. Bujar Obertinca, në bazë të ekzaminimit të dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, ka konstatuar se paditësi *B.TH*, si pasojë e aksidentit, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare ka përjetuar disa sekonda, e përcjell me ndjenjën e përfundimit të jetës. Frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar në kohëzgjatje prej 1 orë, në formë të konfuzionit, brengës për paraqitjen e pasojave. Frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar në kohëzgjatje prej 3 muaj, e manifestuar me vështirësi rreth adaptimit në kushtet e reja për shkak të lëndimeve të kokës dhe lëvizjeve të kufizuara (bartjes së qafores), duke i shkaktuar pengesa në realizimin e aktiviteteve të përditshme, e që në aspektin psikik i kanë shkaktuar ankth, ankth, pagjumësi, dridhje të trupit, irritabilitet, inkontiençë emocionale, ulje të pragut të reagimit në situata

frustrative. Frikë sekondare të intensitetit të ulët ka përjetuar në kohëzgjatje prej 12 muaj të tjerë, herë pas here.

Gjykata, ekspertizat mjekësore, atë të Ortopedisë dhe Psikiatrisë, i ka pranuar në tërësi si të besueshme, me që të njëjtat ishin profesionale dhe të argumentuara, të punuar sipas vëllimit të përcaktuar, duke ofruar të dhëna lidhur me vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Nga dëftesa me numër 248412, e datës 11.05.2016, dëftesa me numër 277440, e datës 12.05.2016, dhe kuponin fiskal me numër 0015, të datës 12.05.2016, lëshuar nga NSH "S...", gjykata ka provuar faktin se paditësi F.M, ka pasur shpenzime të shërimit në shumë prej 29.70€, dhe të njëjtat, bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjekësor, i përgjigjen nevojave të shpenzimeve gjatë mjekimit.

Nga Kuponi fiskal me numër 0016, i datës 12.05.2016, lëshuar nga NSH "S...", gjykata ka provuar faktin se paditësi Naim Konjusha, ka pasur shpenzime të shërimit në shumë prej 26.80€, dhe të njëjtat, bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjekësor, i përgjigjen nevojave të shpenzimeve gjatë mjekimit.

Nga dëftesa me numër 248413, e datës 11.05.2016 dhe kuponin fiskal numër 0014, i datës 12.05.2016, lëshuar nga NSH "S...", gjykata ka provuar faktin se paditësi B.TH, ka pasur shpenzime të shërimit në shumë prej 32.20€, dhe të njëjtat, bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjekësor, i përgjigjen nevojave të shpenzimeve gjatë mjekimit.

Gjykata gjen se në këtë çështje juridike kontestimore baza juridike e kërkesëpadisë është në dispozitat e Ligjit Nr.04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe Ligjit Nr.04/L077 për marrëdhëniet e detyrimeve, e posaçërisht në dispozitat në vijim.

Me nenin 9, paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, është përcaktuar mbulesa siguruuese, ashtu që sigurimi nga auto përgjegjësia mbulon dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik. Kurse me nenin 10 të tij përcaktohet e drejta për kompensim për dëmin material dhe jo material, i cili duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve. Ndërsa me nenin 18, paragrafi 1 dhe 2, të ligjit të njëjtë është përcaktuar se “Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja. 2. Në rast dëmi të shkaktuar nga mjete motorik sipas paragrafit 1. të këtij”

Ligji Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material), ashtu që me nenin 136, paragrafi 1 është përcaktuar se kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Me nenin 140 përcaktohet se “fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.”. Kurse me nenin 159, të po të njëjtit ligj, përcaktohet se “në rast aksidenti të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”.

Me nenin 137 të të ligjit në fjalë (LMD) përcaktohet se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)”. Kurse me dispozitën e nenit 183, paragrafi 1, të po të njëjtit ligj, përcaktohet se për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.

Me dispozitën e nenit 176, paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve është përcaktuar se “ I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar.”

Bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara, gjykata gjen se pala e paditur është përgjegjëse për kompensimin e dëmit të pësuar nga pala paditëse, pasi që shkaktar primar i aksidentit të datës 11.05.2016, nga ka rrjedhur edhe dëmi, ka qenë ngasësi i automjetit 0....., Gani Sallova, i siguruar tek e paditura Kompania e Sigurimeve “S....”, kurse ngasësi i automjetit 0....., i siguruar tek e paditura “I....”, ka dhënë kontribut sekondar, dhe në këto rrethana, kompensimi i palës së dëmtuar në aksident bëhet mbi bazën e sigurimit nga auto përgjegjësia, konform nenit 136, 159 dhe 176 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, nenit 9, paragrafi 1.1 dhe nenit 18, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia.

Gjykata, lidhur me kërkesëpadinë e paditësit F.M, ka gjykuar shumat si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që në këtë rast kërkesëpadia e paditësit është drejtuar vetëm ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “S....”, e bazuar në ekspertizën e komunikacionit rrugor, dhe vlerësimin e gjykatës, nga baza e auto përgjegjësisë, ka përgjegjësi për kompensimin e dëmit të pësuar nga paditësi në proporcion prej 80%. Andaj edhe shumat e aprovuara, me arsyetimet si

më poshtë, i referohen proporcionit prej 80% të dëmit të pësuar në aksidentin e datës 11.05.2016, nga paditësi në fjalë.

Gjykata në emër të dhimbjeve fizike, aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit *F.M.*, në raport me të paditurën Kompania e Sigurimeve “S...” Sh.A., në shumë prej 1,200.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, të vlerësuara si lëndime të lehta trupore, dhe si pasojë e lëndimeve të pësuar prej tij, ka përjetuar dhimbje të intensitetit të rëndë 48 orë, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 3 javësh, kurse dhimbjet me intensitet të ulët në kohëzgjatje prej 12 muajsh, kohë pas kohe.

Në emër të kompensimit lidhur me frikë, për paditësin *F.M.*, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 840.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit të paditësit, nga se me Ekspertizën mjekësore nga lëmi i Psikiatrisë, është provuar fakti se paditësi, si pasojë e aksidentit të komunikacionit, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare, frikë primare disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë 1 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 3 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët në kohëzgjatje prej 12 muajve tjerë, kohë pas kohe.

Gjykata, në emër të ushqimit të përforcuar për paditësin *F.M.*, ka caktuar kompensimin në shumën nga 117.16€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se, si pasojë e aksidentit, paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 3 jave, i pajisur me proteina, minerale dhe vitamina.

Në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë, gjykata ka caktuar kompensimin në shumën nga 117.16€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike, ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë, është provuar fakti se paditësi si pasojë e aksidentit, ka pasur nevojë për këtë ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë, për shkak të paaftësisë së pjesshme, në kohëzgjatje prej 3 jave.

Në emër të shpenzimeve të shërimit, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë në shumë prej 23.76.00€, në proporcion prej 80% të shpenzimeve të shërimit, pasi që nga provat e administruara në këtë procedurë kontestimore, dhe atë dëftesa me numër 248412, e datës 11.05.2016, dëftesa me numër 277440, e datës 12.05.2016, dhe kuponin fiskal me numër 0015, të datës 12.05.2016, lëshuar nga NSH “S...”, gjykata ka provuar faktin se paditësi *F.M.*, ka pasur shpenzime të shërimit në shumë prej 29.70€, dhe të njëjtat shpenzime i përgjigjen nevojave të

shpenzimeve gjatë mjekimit.

Gjykata në emër të dhimbjeve fizike, aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit *Naim Konjusha*, në shumë prej 2,000.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, të vlerësuara si lëndime të lehta trupore, dhe si pasojë e lëndimeve të pësuar prej tij, ka përjetuar dhimbje të intensitetit të rëndë 72 orë, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 4 javë, kurse dhimbjet me intensitet të ulët në kohëzgjatje prej 2 vitesh, kohë pas kohe.

Në emër të kompensimit lidhur me frikë, për paditësin *Naim Konjusha*, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,428.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit të paditësit, nga se me Ekspertizën mjekësore nga lëmi i Psikiatrisë, është provuar fakti se paditësi, si pasojë e aksidentit të komunikacionit, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare. Frikë primare ka përjetuar disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë 1 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 4 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët rreth 2 vite pasuese, herë pas here.

Gjykata, në emër të ushqimit të përforcuar për paditësin *Naim Konjusha*, ka caktuar kompensimin në shumën nga 147.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se, si pasojë e aksidentit, paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 21 ditëve, i pajisur me proteina, minerale dhe vitamina.

Në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë, gjykata ka caktuar kompensimin në shumën nga 147.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike, ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë, është provuar fakti se paditësi si pasojë e aksidentit, ka pasur nevojë për këtë ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë, për shkak të paaftësisë së pjesshme, në kohëzgjatje prej 21 ditëve.

Gjykata në emër të dhimbjeve fizike, aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit *B.TH*, në shumë prej 1,500.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike – ekspertiza mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se paditësi si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, të vlerësuara si lëndime të lehta trupore, dhe si pasojë e lëndimeve të pësuar prej tij, ka përjetuar dhimbje të intensitetit të rëndë 48 orë, dhimbje me intensitet të mesëm në kohëzgjatje prej 3 javësh, kurse dhimbjet me intensitet të ulët në kohëzgjatje prej 12 muajsh, herë pas here.

Në emër të kompensimit lidhur me frikën për paditësin B.TH, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 1,050.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit të paditësit, nga se me Ekspertizën mjekësore nga lëmi i Psikiatrisë, është provuar fakti se paditësi, si pasojë e aksidentit të komunikacionit, ka përjetuar frikë primare dhe sekondare, frikë primare disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë 1 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 3 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët 12 muaj tjerë.

Gjykata, në emër të ushqimit të përforcuar për paditësin B.TH, ka caktuar kompensimin në shumën nga 147.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë është provuar se, si pasojë e aksidentit, paditësi ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 21 ditëve, i pajisur me proteina, minerale dhe vitamina.

Në emër të kujdesit dhe ndihmës së huaj nga personi i tretë, gjykata ka caktuar kompensimin në shumën nga 147.00€, si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse me provën e nxjerrë në këtë çështje juridike, ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë, është provuar fakti se paditësi si pasojë e aksidentit, ka pasur nevojë për këtë ndihmë dhe kujdes nga personi i tretë, për shkak të paaftësisë së pjesshme, në kohëzgjatje prej 21 ditëve.

Në emër të shpenzimeve të shërimit, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit B.TH, në shumë prej 32.20€, pasi që nga provat e administruara në këtë procedurë kontestimore, dhe atë dëftesa me numër 248413, e datës 11.05.2016, dhe kuponin fiskal numër 0014, i datës 12.05.2016, lëshuar nga NSH "S...", është provuar se i njëjti, si pasojë e aksidentit, ka krijuar shpenzime të shërimit në shumë prej 32.20€, dhe të njëjtat shpenzime i përgjigjen nevojave për diagnostifikim, mjekim dhe rehabilitim.

Gjykata, vlerëson se shumat e kompensimit për dëmin jomaterial, të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësve dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të dëmshpërblimit, do t'i mundësoj paditësve satisfaksion që të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojnë të mirat jo materiale nga të cilat janë privuar, si dhe duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të pësuar, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e nevojshme të shërimit. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi shpërblimin e dëmit jomaterial, si dhe në lidhje me shumën kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkëljes së të mirës dhe të qëllimit të cili i shërben ky kompensim, siç përcaktohet me nenin 183 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve.

Gjykata, në emër të dëmit material për ushqim të përforcuar, ndihmë e kujdes të huaj, dhe shpenzimet e shërimit, ka aprovuar shumat si në pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 179, paragrafi 1 të Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, ku është përcaktuar se “kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.” Në këtë rast paditësve i’u takon e drejta në kompensim të këtij lloji të dëmit material, për ushqim të përforcuar dhe kujdesin e huaj, përkundër faktit se paditësit për këto kategori të dëmit nuk kanë prezantuar prova konkrete materiale. Gjykata, vlerëson se paditësve i’u takon ky kompensim, duke u bazuar edhe në praktikën e gjertanishme gjyqësore, ku është konstatuar se në shumicën dërmuese të rasteve, palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi për këtë lloj kompensimi, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar, i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Këto kategori të kompensimit, janë të njohura edhe me Rregullore për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e dëmeve jomateriale nga auto përgjegjësia, e cila nuk është obliguese për gjykatat në rastin e vendosjes, por mund të merret si kriter orientues, rezulton se kompanitë e sigurimeve në rastet e aksidenteve të komunikacionit, të dëmtuarve u njohin të drejtën në kompensimin e dëmit për ushqim të përforcuar dhe për kujdesin dhe ndihmën e huaj nga personi i tretë.

Gjykata, ka vendosur si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve që ndërlidhet me dëmin jomaterial, pasi që vlerësoj se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë. Kurse sa i përket dëmit material, gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit F.M sa i përket ushqimit të përforcuar në shumë prej 182.40€, ndihmës dhe kujdesit të personit të huaj në shumë prej 182.40€, shpenzimeve të shërimit në vlerë prej 5.94€, pasi që në vlerësimin e gjykatës, bazuar në ekspertizën mjekësore nga lëmi i ortopedisë dhe dëftesa me numër 248412, e datës 11.05.2016, dëftesa me numër 277440, e datës 12.05.2016, dhe kuponin fiskal me numër 0015, të datës 12.05.2016, paditësit për ushqim të përforcuar dhe kujdes të personit të huaj, i takon kompensimi nga 147.00€, ndërsa për shpenzime të shërimit i takon kompensimi në shumë prej 29.70€, por gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit mbi shumat e vlerësuara dhe për 20% të dëmit të njohur nga gjykata, pasi që në këtë rast e paditura, Kompania e Sigurimeve “S....” mban përgjegjësi për kompensimin e dëmit vetëm në proporcionin prej 80% të dëmit pësuar nga paditësi F.M. Ndërsa për paditësit N.K dhe B.TH, gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë për ushqim të përforcuar



në shumë prej 153.00€, për përkujdesjen e personit të huaj në shumë prej 153.00€, pasi që vlerësimin e gjykatës shumë e gjykuara për kategorinë e kompensimit për ushqimit të përforcuar dhe kujdesit të personit të huaj janë në harmoni me qëllimin e kompensimit dhe praktikën gjyqësore për këtë lloj kompensimi.

Kurse sa i përket kompensimit të dëmit material për rehabilitim fizioterapeutik, gjykata, bazuar në nenin 322 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ka refuzuar kërkesëpadinë për rehabilitim për të tre paditësit, për secilin nga 400.00€, sepse nuk janë ofruar prova mbi bazën e të cilave do të provoheshin shpenzimet e bëra për qëllime të këtij kompensimi të pretenduar.

Gjykata i ka vlerësuar si të pa bazuar pretendimet e të paditurës së dytë, Kompania e Sigurimeve “I...” Sh.A., se kërkesa për dëmshpërblim në raport me të paditurën e dytë është parashkruar. Kjo sepse aksidenti i komunikacionit, nga ku pala paditëse është dëmtuar ka ndodhur me datë me datë 11.05.2016, kurse padinë në gjykatë e ka ushtruar me datë 06.07.2016, që do të thotë se me ushtrimin e padisë në gjykatë është ndërprerë rrjedhja e afatit të parashkrimit të kërkesës. Kjo bazuar edhe në dispozitën e nenit 369 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, ku është përcaktuar se “parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrur kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”. Në rastin konkret, paditësit, pas pranimit të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.4527/18, të datës 06.05.2019, me parashtrësën e datës 23.08.2019 ka zgjeruar padinë edhe ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “I...”, e cila nuk e ka kundërshtuar zgjerimin e padisë dhe ka vazhduar të marr pjesë në seancat gjyqësore. Bazuar në dispozitën e nenit 260 dhe 264 të LPK-së pala paditëse mund ta ndryshojë padinë ashtu që në vend të të paditurit të parë ta padisë një person tjetër apo të zgjeroj padinë edhe në një të paditur tjetër, që do të thotë se si palë e paditur mund të përfshihet edhe një person tjetër i cili nuk ka qenë pjesë e procesit të zhvilluar deri në fazën përkatëse të procedurës. “Personi i cili hynë në gjykim në vend të palës së paditur duhet ta pranojë atë në gjendjen në të cilën ndodhet në momentin kur hyn në të”, citat nga paragrafi 3 i nenit 260 dhe 264. Pra me dhënien e pëlqimit të paditurës së dytë për zgjerimin e padisë edhe kundër saj dhe pjesëmarrjen në seancat e shqyrtimit kryesor, e paditura Kompania e Sigurimeve “I...”, procesin kontestimor e ka pranuar në fazën në të cilën ka qenë, me të gjitha veprimet procedurale të kryera deri në atë fazë të procedurës dhe për këtë edhe padia e ushtruar nga pala paditëse me datë 11.05.2016, ka ndërprerë parashkrimin edhe ndaj të paditurës së dytë, Kompania e Sigurimeve “I...”.

Duke qenë se pas administrimit të të gjitha provave, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se të paditësve i'u takon edhe kamatëvonesa, e përcaktuar me nenin 382 të Ligjit Nr.04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, sipas të cilit debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhi kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8 %) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë. Kamata, për dëmin material për të paditurën e parë, Kompania e Sigurimeve "S...", fillon të rrjedh nga dita e paraqitjes së kërkesës për kompensim, përkatësisht nga data 20.05.2016, kurse për të paditurën e dytë, Kompania e Sigurimeve "I...", nga data e njoftimit të të paditurës për zgjerimin e padisë, 25.08.2022. Ndërsa për dëmin jo material nga data e marrjes së këtij aktgjykimi, përkatësisht data 03.07.2023, e gjerë në përmbushjen e plotë të detyrimit.

Vendimin që të paditurat t'i bartin shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore të neneve 449 dhe 452 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe Tarifës së OAK-së, për vlerën e kontestit deri në dhjetëmijë euro, sipas së cilës paditësve u pranohen shpenzimet në shumë të përgjithshme prej 1,636.68€, të cilat duhet t'u kompensohen paditësve nga të paditurat, sipas proporcionit të përgjegjësisë dhe numrit të paditësve ndaj të paditurave, dhe atë e paditura e parë, Kompania e Sigurimeve "S...", për 80% të përgjegjësisë, për tre paditësit, shumën prej 1,355.52€, ndërsa e paditura e dytë, Kompania e Sigurimeve "I...", për 20% të përgjegjësisë, për paditësit N.K dhe B.TH, shumën prej 281.16€. Shpenzimet e procedurës të njohura paditësve janë: për përpilim të padisë shumën prej 198.00€, për përfaqësim e paditësve në tri seanca të mbajtura dhe një seancë të shtyrë pa fajin e avokatit të palës paditëse shumën prej 899.00€, për marrjen e provës me ekspertizë mjekësore shumën prej 500.00€, dhe për taksë gjyqësore për padi shumën prej 40.00€. Shpenzimet e procedurës të njohura në këtë çështje juridike për përpilim të padisë dhe për përfaqësim të paditësve në seancat gjyqësore nga avokati, janë përlllogaritur bazuar në tariforin 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, për vlerat e kontestit deri në 10,000.00€ si dhe nenin 452, paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, pasi që pjesa e aprovuar e padisë për të tre paditësit është nën vlerën 10,000.00€. Ndërsa të paditurat janë obliguar që të njëjtat t'ua kompensojnë paditësve, në shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga se kërkesëpadija e paditësve N.K dhe B.TH është drejtuar ndaj dy të paditurave, kurse kërkesëpadija e paditësit Naim Murturi është drejtuar vetëm ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve "S...". Shpenzimet në raport me të paditurën Kompania e Sigurimeve "S..." janë njohur në proporcion prej 80% të vlerës së kompensimit për avokat, për përfaqësimin e tre paditësve, kurse në raport me të paditurën Kompania e Sigurimeve "I..." në proporcionin prej 20% të vlerës së kompensimit për avokat, për përfaqësimin e dy paditësve. Shpenzimet e krijuara për taksë gjyqësore për padi dhe marrjen e provës me ekspertizë mjekësore

janë njohur në tërësi nga gjykata, dhe janë obliguar të paditurat që të njëjtat t'ia kompensojnë paditësve sipas proporcionit të përgjegjësisë së të paditurave (80% me 20%).

Gjykata nuk ka njohur shpenzimet e procedurës mbi shumën prej 1,636.68€ e deri në 4,128.00€, apo shumën prej 2,491.32€, bazuar në suksesin e palëve në procedurë, i përcaktuar me dispozitën e nenit 452, paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, pasi që paditësit pjesërisht kanë pasur sukses. Shumat e aprovuara nga gjykata janë nën vlerën 10,000.00€ të kontestit, ashtu që shpenzimet lidhur me përpilimin e padisë dhe përfaqësimin e paditësve janë njohur sipas tariforit 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifatat e Avokatëve, për vlerat e kontestit deri në 10,000.00€. Po ashtu gjykata nuk ka njohur edhe shpenzimet e kërkuara në shumë prej 520.00€ për parashtrësën e datës 16.05.2023 për ndryshimin dhe zmadhimin e lartësisë së kërkesëpadisë, të dorëzuar në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 14.06.2023, si dhe shumën prej 520.00€, për zgjerimin e kërkesëpadisë edhe ndaj të paditurës së dytë, pasi që ky kompensim është konsumuar me shpenzimet e njohura për padi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.1494/16, datë 03.07.2023

Gjyqtari

Nexhat Qallapeku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të tij, Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.